



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË



Nr. _____ Prot

Korçë, më 20.08.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Date 20.08.2024

Drejtuar: **Shoqërisë “Nika”sh.p.k adresa:** Shkoder Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godine 8-kateshe, kati i I-re, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587” 4001.

Procedura e prokurimit: **Procedure e hapur**

Numri i procedurës **REF-12155-07-04-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës :

Objekti: **“Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Sevasti Qiriazhi" Korçë ”**

Afati: **4 muaj**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike : **Nr. 35, Date 08.07.2024,Nr 51 Datë 15.08.2024.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.Shoqëria “ Nika ” shpk, NIPT J76705047U me vleren:

41.080.668,70 (dyzet e nje milion e tetedhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtedhjetë e tete, presje shtatedhjetë)lekë, pa tvsh.

2.Shoqëria “ Ina ” shpk, NIPT J61814009W me vleren:

41.945.507,17 (dyzet e nje milion e nenteqind e dyzet e pese mijë e peseqind e shtate, presje

shtatembedhjete)lekë, pa tvsh.

- 3. Bashkimi i operatoreve “ RSM COMPANY ” nr.biznesi 810802422, dhe “ Desaret Company ” shpk, NIPT K01816001J me vleren:**
42.027.159 (dyzet e dy milion e njezet e shtate mije e njeqind e pesedhjete e nente)leke, pa tvsh
- 4. Shoqëria “ Rej” shpk, NIPT J93711608Q me vleren:**
43.043.827,45 (dyzet e tre milion e dyzet e tre mije e teteqind e njezet e shtate, presje dyzet e pese)lekë, pa tvsh.
- 5. Bashkimi i operatoreve “ Konstruksion 93 ” shpk, NIPT J64103148B dhe “ Hasta Engineering ” shpk, NIPT M11511002J me vleren:**
45.435.925 (dyzet e pese milion e katerqind e tridhjete e pese mije e nenteqind e njezet e pese) lekë, pa tvsh.
- 6. Bashkimi i operatoreve “ Infinit ” shpk, NIPT J74304623M dhe “ J O G I” shpk, NIPT J63229478K me vleren:**
45.581.450,91(dyzet e pese milion e peseqind e tetedhjete e nje mije e katerqind e pesedhjete, presje nentedhjete e nje) lekë, pa tvsh.
vlera pas korrigjimit
- 7. Bashkimi i operatoreve “ Xhengo ” shpk NIPT J64103171M, dhe “ Curri ” shpk, NIPT J67902718S me vleren:**
45.887.208 (dyzet e pese milion e teteqind e tetedhjete e shtate mije e dyqind e tete) leke, pa tvsh
- 8. Shoqeria “2 N” shpk, NIPT L31615017L me vlerën:**
57.193.455 (pesedhjete e shtate milion e njeqind e nentedhjete e tre mije e katerqind e pesedhjete e pese) leke, pa tvsh
vlera pas korrigjimit
- 9. Bashkimi i operatoreve “Vildev-CO ” shpk NIPT K83926001F, dhe “ A.L-Asfalt ” shpk, NIPT K81511508A me vleren:**
46.383.056 (dyzet e gjashte milion e treqind e tetedhjete e tre mije e pesedhjete e gjashte) leke, pa tvsh
- 10. Shoqeria “Fled” shpk, NIPT K17621104C me vlerën:**
47.209.781,95 (dyzet e shtate milion e dyqind e nente mije e shtateqind e tetedhjete e nje, presje nentedhjete e pese) leke, pa tvsh
- 11. Bashkimi i operatoreve “Boshnjaku. B ” shpk NIPT K72627402H, dhe “ Z D R A V A ” shpk, NIPT J84003411K me vleren:**
48.371.352 (dyzet e tete milion e treqind e shtatedhjete e nje mijë e treqind e pesedhjete e dy) leke, pa tvsh
- 12. Bashkimi i operatoreve “Viscons Group ” shpk NIPT L96513208E, dhe “ I.C.C Group ” shpk, NIPT L51308006A me vleren:**
48.537.112 (dyzet e tete milion e peseqind e tridhjete e shtate mije e njeqind e dymbedhjete) leke, pa tvsh

13. Shoqëria “ ASI -2A CO ” shpk, NIPT K53002402C me vleren:

48.805.195,90 (dyzet e tete milion e teteqind e pese mijë e njëqind e nentedhjete e pese, presje nentedhjete) leke, pa tvsh

14. Bashkimi i operatoreve “ MF INVEST GROUP ” shpk NIPT L71830010R, dhe “ MANE/S ” shpk, NIPT J64103865K me vleren:

48.942.466,63 (dyzet e tete milion e nenteqind e dyzet e dy mijë e katerqind e gjashtedhjete e gjashte, presje gjashtedhjete e tre) leke, pa tvsh

15. Shoqëria “ Lis Konstruksion ” shpk, NIPT K66613407H me vleren:

50.558.497,18 (pesedhjete milion e peseqind e pesedhjete e tete mije e katerqind e nentedhjete e shtate, presje tetembedhjete) leke, pa tvsh

16. Bashkimi i operatoreve “ Glavenica ” shpk, NIPT K17710805A ” dhe “ Ngracan 1934 ” shpk, NIPT J87602809S me vleren:

51.391.497 (pesedhjete e nje milion e treqind e nentedhjete e nje mije e katerqind e nentedhjete e shtate) leke, pa tvsh

17. Shoqëria “ Avduli ” shpk, NIPT J66703306O me vleren:

54.297.894 (pesedhjete milion e peseqind e pesedhjete e tete mije e katerqind e nentedhjete e shtate, presje tetembedhjete) leke, pa tvsh

18. Shoqëria “ T & XH ” shpk, NIPT L72121504I me vleren:

*57.335.305,26 (pesedhjete e shtate milion e treqind e tridhjete e pese mije e treqind e pese, presje njezet e gjashte) leke, pa tvsh
vlera pas korrigjimit*

19. Shoqëria “ Senka ” shpk, NIPT J94808405Q me vleren:

61.304.035,03 (gjashtedhjete e nje milion e treqind e kater mijë e tridhjetë e pesë, presje tre) leke, pa tvsh

20. Shoqëria “ Zeqillari ” shpk, NIPT L61912024O me vleren:

Nuk ka paraqitur oferte ekonomike

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i operatoreve “ Konstruksion 93 ” shpk, NIPT J64103148B dhe “ Hasta Engineering ” shpk, NIPT M11511002J, per arsye se:

1. Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, Kriteret e pergjithshme të kualifikimit pika 1.Ç ku percaktohest se : *“Ofertuesi deklaroi se:*

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së” dhe kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 1.a, për arsye se në formularin e vetdeklarimit sipas shtojcës 8, në pikën A-DEKLARATA PER PERMBUSHJEN E KRITEREVE TE PERGJITHSHME TE KUALIFIKIMIT, **nuk janë shënuar personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik për të cilët ofertuesi duhet të deklarojë se nuk janë të dënuar sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP.** Pra nuk është bërë plotësimi i kësaj shtojcë sipas kërkesave të saj dhe si rrjedhim autoriteti kontraktor nuk mund të bëjë verifikimet për gjendjen gjyqësore sipas parashikimeve të shkresës të përbashkët të APP Nr 1155 Prot dhe Ministrisë të Drejtësisë Nr 1001/1 Prot datë 01.02.2019 .

2. Nuk plotëson kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e veçanta të kualifikimit , pika 2.2.6 lidhur me disponimin e mjeteve.

Konkretisht : në dokumentat e tenderit janë kërkuar : 1 kamion me kapacitet mbajtes mbi 10 ton dhe 3 kamione me kapacitet mbajtes deri 5 ton, pra gjithsej 4 kamiona.

Ndërsa nga ofertuesi janë deklaruar vetëm dy kamione ,konkretisht nga shoqëria Konstruksion 93, MAN 20M3 me targe AB396LF DHE KAMION MERCEDEZ BENZ AB241LF.

3. Tek preventivi i punimeve Zeri “Shuma TVSH (20%) dhe zeri vijues “SHUMA E NDËRTIMIT” janë lënë bosh, pa u plotësuar me shifrat përkatëse.

Oferta refuzohet bazuar në përcaktimin e bërë në shtojcën 2.”Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit” ku është përcaktuar se “Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës”

4. Ka pasaktësi gjatë plotësimit të shtojcës 2 Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit ku në shumën totale (shuma e ndërtimit + Totali makineri dhe pajisje) nuk është përfshirë TVSH-ja.

5. Në ofertën e paraqitur nga ofertuesi rezultoi se është bërë gabim në llogaritjen e vlerës me tvsh të shënuar në shtojcën 1 Formulari i ofertës.

Vlera totale e ofertës me tvsh mbas korigjimit rezulton : 36.009.499 lek+ 7.201.899 lek+9.426.426 lek=**52.637.824,86** lekë

Nga ofertuesi vlera totale e ofertës me TVSH është shënuar **54.523.110** lek në shtojcën 1 Formulari i ofertës .

Për sa më sipër ofertuesi skualifikohet bazuar në nenin 82 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet shprehimisht se: "Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:- shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

2. Bashkimi i operatoreve “ Infinit ” shpk, NIPT J74304623M dhe “ J O G I” shpk, NIPT J63229478K, për arsye se:

1. Nuk plotëson kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e veçanta të kualifikimit, pika

2.2.1 ku është përcaktuar shprehimisht se:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël** se 49 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se 199%** i vlerës limit të kontratës që prokurohet;

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Konkretisht: Ofertuesi ka marrë pjesë si bashkim shoqërisht ku shoqëria Infinit sh.p.k ka marrë përsipër të realizojë 30% të punimeve dhe shoqëria Jogi sh.p.k ka marrë përsipër të kryejë: 70% të punimeve.

Në nenin 88 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik përcaktohet se:

"Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim."

Si rrjedhim shoqëria Jogi sh.p.k duhet të paraqesë dëshmi për realizimin e punëve të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 49 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se shoqëria Jogi sh.p.k për përmbushjen e këtij kritერი ka paraqitur:
1-Kontratën me objekt "Rikonstruksion +shtesë anësore në shkollën 9-vjecare,fshati Shënepremte,Bashkia Divjakë" me vlerë 33.721.449 lek me tvsh, në të cilën shoqëria Jogi sh.p.k ka kryer 90% të punimeve ose në vlerë monetare : 30.349.304 lek me tvsh dhe 25.291.087 lek pa tvsh.

Si rrjedhim ky objekt është me vlerë me të vogël se vlera e kërkuar në kriterin e vendosur

3. Shoqëria "2 N" shpk, NIPT L31615017L per arsye se:

Ofertuesi s'kualifikohet bazuar ne nenin 82 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet shprehimisht se: "Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

Konkretisht:

Ne ofertën e paraqitur nga ofertuesi rezultoi se është bere gabim ne llogaritjen e vlerës pa tvsh të shënuar në shtojcën 1 Formulari i ofertës .

Në formularin e ofertës të publikuar me dokumentat e tenderit është vendosur shënimi:

"Tek cmimi total i ofertes pa TVSH ofertuesit duhet te shenojne vleren qe del nga shuma e punimeve ndertimore pa tvsh+ TOTALI MAKINERI DHE PAJISJE"

Vlera totale e ofertës pa tvsh mbas korrigjimit rezulton : Shuma e punimeve ndertimore pa tvsh 46.242.990,78 + **TOTALI MAKINERI DHE PAJISJE 10.950.464,00 = 57.193.454,78 lek,pa tvsh.**

Nga ofertuesi në shtojcën 1 Formulari i ofertes,vlera totale e ofertës pa TVSH është shënuar 46.242.990,78 lek,pa tvsh.

4. Bashkimi i operatoreve "Vildev-CO " shpk NIPT K83926001F, dhe " A.L-Asfalt " shpk, NIPT K81511508A per arsye se:

1.Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7,kriteret e vecanta të kualifikimit,pika 2.2.1 lidhur me punët e ngjashme ku është përcaktuar shprehimisht se:

-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomikë.

Konkretisht:Për plotësimin e këtij kriteri janë paraqitur kontratat “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”lidhur ndërmjet Bashkisë Devoll dhe BOE “Vildev-Co dhe Alb Korca” sh.p.k

Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”lidhur ndërmjet Bashkisë Maliq dhe BOE “Vildev-Co dhe Alb Korca” sh.p.k.

Rikonstruksion objekte shkollore+terrene lidhur ndërmjet Bashkisë Maliq dhe BOE “Vildev-Co dhe Alb Korca” sh.p.k.

“Meremete 2020” lidhur ndërmjet NSHMAC dhe BOE “Vildev-Co dhe Alb Korca” sh.p.k.

Për të gjitha këto kontrata nuk është paraqitur *Kontrata Bashkimit te operatoreve ekonomikë.*

Ndërsa vetëm kontrata me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare” Vithkuq e lidhur me Bashkinë Korçë është me vlerë 3.473.369 lek,me tvsh,nuk plotëson vlerën e kërkuar për punët e ngjashme.

5. Bashkimi i operatoreve “Viscons Group ” shpk NIPT L96513208E, dhe “ I.C.C Group ” shpk, NIPT L51308006A per arsye se:

1.Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, kriteret e veçanta të kualifikimit,pika 2.2.1 lidhur me punët e ngjashme ku është përcaktuar shprehimisht se:

“Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomikë.”

Konkretisht për kontratat : Rikonstruksion Kopshti Maliq dhe Rikonstruksion i Fasadave në lagjen Demokracia dhe perimetrin e rruges Ndricimi i rruges E.Bilbili unaza veriore e qytetit Tepelenë” të cilat janë realizuar si Bashkim Operatorësh, nuk është paraqitur Kontrata Bashkimit te operatoreve ekonomikë.

Ndërsa vetëm kontrata me objekt “Loti 2 Rikonstruksion i disa QSH-ve në rajonet Elbasan dhe Vlorë (12 objekte)” është me vlerë 38.316.115 lek,me tvsh,ku shoqëria Viskons Group sh.p.k ka kryer 10% të punimeve ose 3.831.611 lek me tvsh/3.193.009 lek pa tvsh nuk plotëson vlerën e kërkuar për punët e ngjashme.

1. Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7,kriteret e vecanta të kualifikimit,pika 2.2.5 ku përcaktohet se:

1.2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 50 persona, dokumentuar kjo me vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore nga administrata tatimore dhe listpagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

Konkretisht: Në marrëveshjen e bashkëpunimit të lidhur ndërmjet shoqërive “I.C.C Group dhe Viscons Group sh.p.k” shoqëria “I.C.C Group” sh.p.k ka marrë përsipër 74.3% të punimeve.

Në nenin 88 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” përcaktohet se: *3.Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”*

Si rrjedhim shoqëria I.C.C Group duhet të kishte $50 \times 74.3\% = 37$ punonjës. Nga deklarimi i bërë në formularin permbledhes te vetëdeklarimit rezulton se kjo shoqëri per muajin e fundit ka 35 punonjës.

6. Shoqëria “ Lis Konstruksion ” shpk, NIPT K66613407H per arsye se:

Ofertuesi s'kualifikohet bazuar ne nenin 82 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet shprehimisht se: "Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:- shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

Konkretisht:

Ne oferten e paraqitur nga ofertuesi rezultoi se eshte bere gabim ne llogaritjen e vlerës të TVSH të shënuar në preventivin e paraqitur.

Nga ofertuesi vlera e TVSH-së është shënuar 2.201.975,66 lek dhe vlera totale e ofertës me tvsh është shënuar 52.760.472,83.

Vlera e TVSH-së mbas korigjimit rezulton : Shuma e punimeve ndertimore pa tvsh 44.039.513,18 x 20%= **8.807.902,64 lek. Mbas mbledhjes të nëntotaleve të korigjuara rezulton se vlera totale e ofertës me tvsh është 59.366.399,81 lek.**

7. Shoqëria “ T & XH ” shpk, NIPT L72121504I per arsye se:

Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7,kriteret e vecanta të kualifikimit,pika2.1.2 ku përcaktohet se :

2.1.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022,2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.10091,date 05.03.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

Konkretisht Bilanci i vitit 2021 nuk eshte i shoqëruar me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar

8. Shoqëria “ Zeqillari ” shpk, NIPT L61912024O

Nuk ka paraqitur oferte ekonomike

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë **“Nika”sh.p.k adresa: Shkoder Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godine 8-kateshe, kati i I-re, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587”** 4001, se oferta e paraqitur me vlerë totale **41.080.668,70 (dyzet e nje milion e tetedhjetë mije e gjashteqind e gjashtedhjetë e tete, presje shtatedhjetë) lekë, pa tvsh,** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Korçë, Drejtoria e Prokurimeve, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi por jo me vone se 5 dite nga kërkesa e per lidhjen e kontrates.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do të vijohet siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak):

PO

JO

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SOTIRAQ FILO**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

**ZV/KRYETARE
BESA SPAHO**